

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbim**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E TERMAVE TË REFERENCËS DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Hartimi i Planit te Veprimit per Menaxhimin e Cilesise se Ajrit ”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**Shërbime për mbrojtjen e ndotjes së ajrit 90731300-3; Shërbime konsulence për çështje mjedisore 90713000-8.

**VLERA E FONDIT LIMIT:12,305,556(dymbëdhjetë milion e treqind e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë)** lekë pa tvsh, me objekt: **“Hartimi i Planit te Veprimit per Menaxhimin e Cilesise se Ajrit ”** vënë në dispozicion me anë të vendimit nr.36 datë 28.03.2024 të Këshillit Bashkiak të Tiranës “Për disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr.125, datë 22.12.2023 ‘Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2024”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave të referencës dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*c. DEKLARATË Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit sipas Shtojcës 5;*

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar) si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik(i ndryshuar): citojmë Neni 83 i LPP(I ndryshuar) “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP (i ndryshuar) “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.Për DEKLARATËN Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit sipas Shtojcës 5 të DST-së është bazuar në VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik(i ndryshuar)Neni 41 pika 4 d) ku citon se Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë

ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë .

## **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP (i ndryshuar), nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 9 të DST-së.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021,2022,2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP (i ndryshuar), si dhe nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar) si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

*"Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

*.... 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale , ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.*

*Objekti i prokurimit është shërbim me natyrë intelektuale , ku është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.*

**2.2.2** Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar), si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar).

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të*

*Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.*

**2.2.3** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR).

\*\*\* Kriteri 2.2.3 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP(i ndryshuar), nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), nenit 41/3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ose ekuivalente të tyre të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- a) **ISO 9001:2015** (ose e përditësuar) - për “Sistemin menaxhimin e cilësisë”
- b) **ISO 14001:2015** (ose e përditësuar) -për “Menaxhimin e mjedisit”
- c) **ISO 45001:2018**(ose e përditësuar)- për “Menaxhimin e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë”
- d) **ISO 4225:2020** (ose e përditësuar) – “ Për cilësinë e ajrit”

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

**Argumentimi:**Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar),

*“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”*

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

*“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”*

### ***Kërkesa për Standardin 9001:2015 ose ekuivalente***

*Certifikata e standardit të cilësisë ISO 9001: është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë se kompanive të të gjithë sektorëve dhe të gjithë përmasave. Ky kriter kërkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi të kontratës objekt prokurimi, sipas standardeve ndërkombëtare.*

*Sistemi i menaxhimit të cilësisë, siguron që operatori ekonomik zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij.*

*Nisur nga proceset e punës kritike, rëndësisë së sistemit dhe shërbimeve që ai ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik, proceset e punës së tij, ti bazojë në standarde botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtësi, dhe efikasitet të shërbimeve të ofruara.*

*Për sa më sipër, kërkesa për ISO 9001 (ose ekuivalente) është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar suksesin e kontratës.*

### ***Kërkesa për Standardin ISO 14001:2015 (ose ekuivalente) - për “Menaxhimin e mjedisit”;***

*specifikon kërkesat e përgjithshme për vendosjen e një sistemi të menaxhimit mjedisor në një kompani. Ai përqendrohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të një kompanie duke e mundur atë për të përmirësuar ndikimin e performancës së përgjithshme mjedisore të kompanisë. Një organizatë mund të marrë dhe zbatojë certifikimin ISO 14001, pavarësisht nga madhësia ose qëllimi i saj. Sistemet e menaxhimit të mjedisit bazuar në ISO 14001 ofrojnë mundësinë për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar aspektet mjedisore të një organizate me qëllim :*

- *Parandalimit të dëmtimit të mjedisit;*
- *Vlerësimin të aspekteve mjedisore;*
- *Përmirësimin e performancës mjedisore;*
- *Respektimin e ligjeve;*
- *Ruajtjen e burimeve natyrore dhe uljen e kostos;*
- *Përmirësimin e imazhit të kompanisë;*
- *Përmirësimin e komunikimit me figurat e autoritetit.*

*Për sa më sipër, kërkesa për ISO 14001:2015 (ose ekuivalente) është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar suksesin e kontratës.*

### ***Kërkesa për Standardin ISO 45001:2018 (ose ekuivalente) - për “Menaxhimin e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë”***

*ISO 45001:2018 (ose ekuivalente) është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria*

*e ushtruar nga ana tije (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.*

*Për sa më sipër, kërkesa për ISO 45001:2018 (ose ekuivalente) është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar suksesin e kontratës.*

### ***Kërkesa për Standardin ISO 4225:2020 – “Për cilësinë e ajrit”***

*ISO 4225:2020 ofron udhëzime për përcaktimin e termave dhe matjeve lidhur me cilësinë e ajrit. Qëllimi i tij është të standardizojë terminologjinë që përdoret në vlerësimin e cilësisë së ajrit, duke lehtësuar komunikimin mes palëve të interesuara në këtë fushë.*

*Përcakton terma esenciale lidhur me cilësinë e ajrit, duke ndihmuar profesionistët të kuptojnë dhe aplikojnë konceptet në mënyrë të njëtrajtshme. Gjithashtu, përshkruan qasje për matjen e parametrave të ndryshëm të cilësisë së ajrit, siç janë ndotësit, temperatura, lagështia.*

*Për sa më sipër, kërkesa për ISO 4225:2020 (ose ekuivalente) është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar suksesin e kontratës.*

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin e specializuar të profileve si më poshtë:

- ✓ **1 (një) Drejtues Projekti/ekipi** ( i cili duhet të ketë eksperiencë të gjerë në fushën e menaxhimit të projekteve që lidhen me cilësinë e ajrit dhe të ketë përfunduar studime të nivelit Master i Shkencave ose ekuivalente në Shkenca Natyrore, Shkenca Inxhinierike ose fusha të ngjashme).
- ✓ **1 (një) Inxhinier Mjedisi** me eksperiencë minimalisht mbi 5 vjet (i cili duhet të ketë një diplomë universitare në Nivel Master i Shkencave në Inxhinieri Mjedisi, ose në fusha të ngjashme dhe të jetë i pajisur me certifikatë që vërteton ekspertizën në vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor sipas legjislacionit në fuqi).
- ✓ **1 (një) Specialist për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit** (i cili duhet të ketë një diplomë universitare në nivel Master i Shkencave në Shkenca Mjedisore, Shkenca Natyrore ose fusha të ngjashme) me eksperiencë minimalisht mbi 5 vjet në monitorimin e cilësisë së ajrit dhe përdorimin e teknologjive për matjen e ndotësve.
- ✓ **1 (një) Specialist Kimist** (i cili duhet të ketë një diplomë universitare në nivel Master i Shkencave në Kimi, Inxhinieri Kimike ose një fushë të ngjashme dhe të jetë i pajisur me certifikatë ISO 14064:2018) me eksperiencë minimalisht mbi 5 vjet.

Staf mbështetës :

- **1(një) Specialist GIS** (i pajisur me certifikatë që siguron përdorimin e sistemeve software *ESRI ArcGIS, QGIS*) dhe (me kualifikim Master ose ekuivalent në studime inxhinierike ose të ngjashme ) me eksperiencë minimalisht mbi 5 vjet.
- **1(një) Specialist i Shëndetit Publik** (i cili duhet të ketë një diplomë universitare në nivel Master i Shkencave në Shëndet Publik ose fushë të ngjashme ) me eksperiencë minimalisht mbi 5 vjet.
- **1 (një) Inxhinier Elektrik** (i cili duhet të ketë një diplomë universitare në nivel Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike ose fushë të ngjashme ) me eksperiencë minimalisht mbi 5 vjet.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

- Eksperienca e punës dhe profilet e specialistëve duhet të vërtetohen nga ana e operatorit ekonomik me kontratë pune/kontratë shërbimi/çdo marrëveshje tjetër kontraktuale (te vlefshme gjatë kohës së hartimit të planit), kopje të librezave të punës, kopje të diplomave, jetëshkrimet (CV) si dhe çdo kualifikim tjetër profesional.

Kriteri 2.3.3 dhe nën pikat e tij do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga ofertuesit i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa për staf është e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen.

Numri i përcaktuar për secilin nga teknikat është përlllogaritur, duke marrë në konsideratë proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës dhe është në përpjestim me natyrën, përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe limitet kohore të parashikuara për të përfunduar këtë kontratë.

**Argumentin teknik per personelin teknik si mëposhtë:**

a) **1 (një) Drejtues Projekti/ekipi** - Drejtues i projektit/ekipit duhet të ketë eksperiencë të gjerë në fushën e menaxhimit të projekteve që lidhen me cilësinë e ajrit dhe të ketë përfunduar studime të nivelit Master i Shkencave ose ekuivalente në Shkenca Natyrore, Shkenca Inxhinierike ose fusha të ngjashme. Duhet përvojë pune, kryesisht në drejtimin e projekteve që lidhen me cilësinë e ajrit, me njohuri specifike në hartimin e planeve të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Të jetë i punësuar/me kontratë shërbimi/çdo marrëveshje tjetër kontraktuale.

-Eksperti kryesor ose menaxheri i projektit ofron udhëzime në hartimin e planeve të veprimit për menaxhimin e cilësisë së ajrit, duke përfshirë analiza të detajuara të burimeve të ndotjes, përcaktimin e masave parandaluese dhe monitorimin e vazhdueshëm të ndikimeve në mjedis. Drejtuesi do të udhëheqë ekipin në përcaktimin e masave teknike për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Gjithashtu, drejtuesi duhet të jetë i aftë të japë udhëzime strategjike në analizimin dhe interpretimin e të dhënave për cilësinë e ajrit, të rekomandojë zgjidhje për përmirësime të vazhdueshme. Drejtuesi i projektit duhet të ketë aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe bashkëpunimi për të punuar me partnerë institucionalë dhe për të prezantuar gjetjet teknike dhe rekomandimet në mënyrë të qartë dhe bindëse për palët e interesuara në nivel lokal. Është përgjegjës për hartimin e metodologjisë me të cilën do të hartohet plani, duke përcaktuar të gjitha detajet dhe hollësitë.

**b) 1 (një) Inxhinier Mjedisi (i pajisur me certifikatë që vërteton ekspertizën në vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor sipas legjislacionit në fuqi)**

Inxhinieri i Mjedisit për Cilësinë e Ajrit është përgjegjës për përcaktimin e masave teknike për përmirësimin e cilësisë së ajrit, me fokus në zgjidhje praktike për reduktimin e ndotjes dhe mbrojtjen e mjedisit. Duhet të ketë një diplomë universitare në Nivel Master i Shkencave në Inxhinieri Mjedisi, ose në fusha të ngjashme. Të ketë mbi 5 vite eksperiencë pune. Të jetë i punësuar/me kontratë shërbimi/çdo marrëveshje tjetër kontraktuale.

-Merr pjesë në hartimin dhe zhvillimin e planit për menaxhimin e cilësisë së ajrit për të parashikuar masa për të minimizuar ndotjen e ajrit. Në këtë rol, inxhinieri i mjedisit bashkëpunon ngushtë me drejtuesin e projektit dhe pjesën tjetër të ekipit për të propozuar zgjidhje të qëndrueshme që përputhen me legjislacionin mjedisor dhe rregullat kombëtare në fushën e menaxhimit të ajrit. Inxhinieri duhet të ketë aftësi të mira komunikimi dhe puna në ekip janë thelbësore për këtë rol, pasi inxhinieri do të bashkëpunojë me institucione, komunitete dhe palë të interesuara për të prezantuar gjetjet dhe rekomandimet teknike në mënyrë të qartë dhe efektive.

Inxhinieri i mjedisit duhet të ketë një përvojë punë mbi 5 vite, për arsye se ka përgjegjësinë e hartimit të masave teknike dhe aktiviteteve. Eksperienca siguron aftësinë e tij për t'u përballur me problemet që mund të lindin gjatë hartimit të planit si dhe mund të ofrojë zgjidhje për secilin problem. Për këtë kërkohet një eksperiencë pune që konsiderohet e mjaftueshme pasi fusha e aktivitetit është mjaft specifike. Periudha 5 vjeçare i jep mundësinë që personi që propozohet të ketë aftësitë e duhura për punët që do të kryejë.

Fusha e cilësisë së ajrit është një fushë mjaft delikate dhe për këtë arsye ekspertët që kanë punuar me të duhet të kenë njohuri në zhvillimet dhe ecurinë e tyre në vendin tonë. Kjo është një arsye që bën eksperiencën 5 vjeçare të domosdoshme për të kuptuar dhe njohur kërkesat në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të fushës, që duhet të zbatohen në nivel lokal.

Gjithashtu kërkesa për të pasur njohuri dhe në zbatimin e projekteve të ngjashme që kanë lidhje me cilësinë e ajrit kërkon një nivel të lartë njohurish dhe që sigurisht lidhet me eksperiencën e gjatë të inxhinierit në njohuritë e ndërlidhjes së fushave të ndryshme.

**c) 1 (një) Specialist për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit**

Specialisti për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit është përgjegjës për mbledhjen, analizimin dhe interpretimin e të dhënave që lidhen me ndotësit atmosferikë dhe cilësinë e ajrit. Duhet të ketë një diplomë universitare në nivel Master i Shkencave në Shkenca Mjedimore, Shkenca Natyrore ose fusha të ngjashme, si dhe përvojë pune mbi 5 vite në monitorimin e cilësisë së ajrit dhe përdorimin e teknologjive për matjen e ndotësve. Të jetë i punësuar/me kontratë shërbimi/çdo marrëveshje tjetër kontraktuale.

-Në këtë rol, specialisti analizon dhe realizon monitorimin e ajrit duke kryer matjet përkatëse, duke përdorur instrumente për të mbledhur të dhëna të sakta mbi ndotësit kryesorë si grimcat (PM), oksidet e



karbonit (CO<sub>x</sub>), oksidet e azotit (NO<sub>x</sub>), ozonin (O<sub>3</sub>), dhe dioksidin e sulfurit (SO<sub>2</sub>). Kryen analizimin e të dhënave dhe përgatit raporte për të identifikuar llojet e ndotjes dhe për të ndihmuar në hartimin e masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Specialisti është i përfshirë në zhvillimin e raporteve të rregullta për gjendjen e cilësisë së ajrit dhe ofron rekomandime për masat e nevojshme për përmirësimin e tij.

Specialisti për monitorimin e cilësisë së ajrit duhet të ketë një përvojë punë mbi 5 vite, për arsye se ka përgjegjësinë direkte për matjen dhe monitorimin e cilësisë së ajrit. Eksperiencia prej 5 vitesh siguron aftësinë e tij në përdorimin e pajisjeve me të cilat do të kryhet monitorimi i cilësisë së ajrit si dhe nxjerrjen dhe analizimin e të dhënave që do të përdoren për hartimin e planit. Periudha 5 vjeçare i jep mundësinë që personi që propozohet të ketë aftësitë e duhura për punët që do të kryejë.

Monitorimi i cilësisë së ajrit është një nga detyrat kryesore që duhet të zhvillohet dhe për këtë arsye eksperti që do të punojë duhet të ketë njohuritë e mjaftueshme dhe eksperiencat e duhura që ka përfituar gjatë ushtrimit të profesionit.

#### **d) 1 (një) Specialist Kimist (I pajisur me certifikatë ISO 14064:2018)**

Specialisti Kimist për Cilësinë e Ajrit është përgjegjës për analiza të thelluara kimike që lidhen me ndotësit atmosferikë dhe vlerësimin e përbërjes së ajrit. Duhet të ketë një diplomë universitare në nivel Master i Shkencave në Kimi, Inxhinieri Kimike ose një fushë të ngjashme dhe të ketë përvojë punë mbi 5 vite në teknikat e monitorimit të ndotjes. Të jetë i punësuar/me kontratë shërbimi/çdo marrëveshje tjetër kontraktuale.

-Në këtë rol, specialisti përdor metoda analitike dhe instrumente të avancuara për të identifikuar ndotësit në ajër, duke përfshirë grimcat, gazet dhe substancat kimike të dëmshme. Specialisti kimist bashkëpunon ngushtë me ekipet e monitorimit të cilësisë së ajrit dhe inxhinierëve për të interpretuar rezultatet e analizave dhe për të ofruar rekomandime për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe minimizimin e ndikimeve të ndotjes në shëndetin publik dhe mjedisin. Aftësitë e mira të komunikimit dhe punës në ekip janë gjithashtu të domosdoshme, pasi specialisti duhet të prezantojë rezultatet dhe rekomandimet për palët e interesuara, përfshirë autoritetet lokale.

Specialisti Kimist duhet të ketë një përvojë punë mbi 5 vite, për arsye se ka përgjegjësinë për të identifikuar ndotësit në ajër dhe interpretuar rezultatet e marra. Eksperiencia prej 5 vitesh siguron aftësinë e tij për të kryer me përgjegjësi detyrat që do t'i ngarkohen si dhe do t'a ndihmojë atë për t'u përballur me probleme të ngjashme që mund të lindin gjatë hartimit të planit. Konsiderojmë se eksperiencia prej 5 vitesh me përvoja të ngjashme është e mjaftueshme për të realizuar qëllimet e planit.

Identifikimi i ndotësve dhe analiza e rezultateve është një nga detyrat kryesore që duhet të zhvillohet dhe për këtë arsye eksperti që do të punojë duhet të kenë njohuri të mjaftueshme dhe eksperiencat e duhura që ka përfituar gjatë ushtrimit të profesionit.

#### **Stafi mbështetës i kontraktorit do të ketë në përbërje ekspertë të profileve si më poshtë:**

#### **e) 1 (një) Specialist GIS (i pajisur me certifikatë që siguron përdorimin e sistemeve software ESRI ArcGIS, QGIS)**

Me kualifikim Master ose ekuivalent në studime inxhinierike ose të ngjashme. Të ketë përvojë të përgjithshme profesionale në sektorin e GIS mbi 5 vite. Të jetë i punësuar/me kontratë shërbimi/çdo marrëveshje tjetër kontraktuale.

-Eksperti GIS do të kontribuojë në ngritjen e një sistemi GIS për përpunimin e të dhënave në nivel lokal, duke përgatitur kështu analizën e të dhënave që do të gjenerohen nga procesi.

Në këtë rol, specialisti zhvillon dhe menaxhon bazat e të dhënave, duke integruar të dhënat mjedisore dhe të dhënat për cilësinë e ajrit për të krijuar harta që ndihmojnë në identifikimin e burimeve të ndotjes. Specialisti GIS punon me inxhinierët, kimistët dhe specialistët e tjerë për të siguruar që të dhënat janë në përputhje me kërkesat e planit.

Specialisti GIS duhet të ketë një përvojë punë mbi 5 vite, për arsye se ka përgjegjësinë ngritjen e sistemit GIS dhe përpunimin e të dhënave. Eksperienca prej 5 vitesh siguron aftësinë e tij në përdorimin e saktë të të dhënave si dhe sistemeve e programeve që do të duhen gjatë hartimit të planit. Periudha 5 vjeçare i jep mundësinë që personi që propozohet të ketë aftësinë dhe eksperiencën e mjaftueshme për analizimin e të dhënave dhe sistemet GIS. Ky specialist do të kryejë detyra të rëndësishme dhe duhet të ketë përvojën e duhur në mënyrë që ato të kryhen me rigorozitet.

#### **f) 1(një) Specialist i Shëndetit Publik**

Specialisti i shëndetit publik është përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e shëndetit të komuniteteve duke analizuar dhe monitoruar faktorët që ndikojnë në shëndetin publik, përfshirë cilësinë e ajrit. Duhet të ketë një diplomë universitare në nivel Master i Shkencave në Shëndet Publik ose fushë të ngjashme, si dhe përvojë pune mbi 5 vite në programe dhe projekte që lidhen me shëndetin publik dhe mjedisin. Të jetë i punësuar/me kontratë shërbimi/çdo marrëveshje tjetër kontraktuale.

-Specialisti do të analizojë të dhënat epidemiologjike për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimin e ndotjes së ajrit në shëndetin e popullsisë, do të zhvillojë dhe propozojë masa për parandalimin e sëmundjeve të lidhura me ndotjen.

Specialisti për Shëndetin Publik duhet të ketë një përvojë punë mbi 5 vite, për arsye se ka përgjegjësinë interpretimin e të dhënave në lidhje me shëndetin e popullsisë. Eksperienca prej 5 vitesh siguron aftësinë e tij për të zhvilluar masa dhe propozime në përmirësimin e shëndetit të komuniteteve. Periudha 5 vjeçare i jep mundësinë që personi që propozohet të ketë aftësitë e duhura dhe përvojën e ngjashme për t'i vënë në funksion të hartimit të planit.

Analizimi i të dhënave që lidhet me shëndetin e popullatës është një nga detyrat kryesore që duhet të zhvillohet dhe për këtë arsye eksperti që do të punojë duhet të ketë njohuri të mjaftueshme dhe eksperiencat e duhura që ka përfituar gjatë ushtrimit të profesionit.

#### **g) 1 (një) Inxhinier Elektrik**

Inxhinieri elektrik është përgjegjës për instalimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemeve që do të përdoren për monitorimin e ndotësve atmosferikë. Duhet të ketë një diplomë universitare në nivel Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike ose fushë të ngjashme, si dhe përvojë pune mbi 5 vite në këtë fushë.

-Inxhinieri elektrik do të mundësojë instalimin e sistemeve që matin parametrat e cilësisë së ajrit dhe stacionet e monitorimit. Siguron funksionimin e rregullt të këtyre sistemeve.

Inxhinieri Elektrik duhet të ketë një përvojë punë mbi 5 vite, për arsye se ka përgjegjësinë e instalimit të pajisjeve që do të përdoren për monitorimin dhe matjen e cilësisë së ajrit. Eksperienca prej 5 vitesh siguron aftësinë e tij teknike për të përmbushur detyrat që lidhen

me instalimin e sistemeve që do të kryejnë matjet. Periudha 5 vjeçare i jep mundësinë që personi që propozohet të ketë aftësitë e duhura dhe përvojën e ngjashme për t'i vënë në funksion këto pajisje.

Matja dhe monitorimi i cilësisë së ajrit është një nga detyrat kryesore që duhet të zhvillohet dhe për këtë arsye eksperti që do të punojë duhet të ketë njohuritë e mjaftueshme dhe eksperiencat e duhura që ka përfituar gjatë ushtrimit të profesionit.

*Referuar termave të referencës, preventivit, natyrës dhe objektit të saj, si dhe shërbimeve të kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor, shfaqet e nevojshme zotërimi i stafit me kompetencat e mësipërme.*

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** *OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.*

- *Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.*
- *Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

*Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara*

*publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.*

### **Argumentim i termave të referencës:**

I.Termet e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën me objekt **“Hartimi i Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit”**, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP (i ndryshuar), si dhe nenit 41, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Objektivi i përgjithshëm i Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit, është të përcaktojë dhe të marrë masa për përmirësimin e cilësisë së ajrit në mjedis që synojnë të shmangin, parandalojnë ose pakësojnë efektet e dëmshme në shëndetin publik dhe mjedisin në territorin e Bashkisë Tiranë. Synojmë monitorimin e cilësisë së ajrit, për të dalë në rezultate konkrete duke analizuar të dhënat në mënyrë që të ndërhyjmë në zonat ku janë tejkaluar vlerat limit dhe të ruajmë nivelin aty ku nuk janë kaluar këto vlera. Synojmë, gjithashtu, marrjen e masave sipas sektorëve përkatës, të cilët ndikojnë në cilësinë e ajrit në mjedis. Plani synon zbatimin e politikave kombëtare në nivel lokal për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe pakësimin e impakteve negative që sjell ndotja e ajrit në jetën dhe shëndetin e qytetarëve. Plani do të tregojë një drejtim për të ardhmen dhe do të nxisë mendimin e përbashkët mes palëve të interesit dhe jo vetëm, që janë të përfshirë në procesin e planifikimit, hartimit, zbatimit të masave praktike dhe veprimeve konkrete në lidhje me cilësinë e ajrit.

Termet e referencës të këtij shërbimi me natyrë intelektuale, janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP (i ndryshuar), si dhe nenit 41, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe OE të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, termet e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Hartimi i Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

### **Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

*Dokumentat e tenderit*  
*Termet e referencës*

## **NJËSIA E PROKURIMIT**